

## **Java e dytë Botërore e Kombeve të Bashkuara për Sigurinë Rrugore 6-12 maj 2013**

Java e dytë Botërore e Kombeve të Bashkuara për Sigurinë Rrugore që do të mbahet në 6-12 Maj 2013 i është përkushtuar sigurisë së këmbësorëve.

Kërkuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Java do të kontribuojë për:

- Të tërhequr vëmendjen për nevojën për sigurinë e këmbësorëve;
- Të gjeneruar veprime mbi masat me të cilat do të punohet për të rritur sigurinë e këmbësorëve
- Arritjen e qëllimit të Dekadës së Veprimit për Sigurinë Rrugore 2011-2020 për të shpëtuar jetën e 5 milion njerëzish.

### **Qëllimet për Javën**

#### **Qëllimi afatshkurtër: një Javë pa dëmtime fatale**

Më shumë se 5000 këmbësorë janë vrarë në rrugët e botës çdo javë. Qëllimi afatshkurtër i Javës është të parandalojë edhe një fatalitet të vetëm për këmbësorët gjatë periudhës 6-12 Maj 2013.

Ka disa masa relativisht të thjeshta që mund të merren paraprakisht për të shpëtuar jetën e këmbësorëve. Me mbështetjen e ekspertëve teknikë, në mbarë botën mund të iniciohet me ndërhyrjet e mëposhtme në komunitetet, me shpresën për të patur një javë pa dëmtime fatale:

- rritjen e njohurive mbi ligjet ekzistuese për shpejtësinë, konsumin e alkoolit gjatë drejtimit të makinës, tërheqjen e vëmendjes gjatë drejtimit të makinës dhe ecjes;
- forcimin e zbatimit të këtyre ligjeve;
- përmirësimin e ndriçimit rreth objekteve të përdorura nga këmbësorët;
- largimin e objekteve nga rrugët të cilat bllokojnë objekte të përdorura nga këmbësorët;
- përmirësimin e sigurisë së rrugëve pranë shkollave
- rritjen e vizibilitetit të kalimtarëve duke inkurajuar përdorimin e materialeve reflektuese.

#### **Qëllimi afatgjatë: ecje e sigurt**

Qëllimi përfundimtar i Javës së dytë Botërore të Kombeve të Bashkuara për Sigurinë Rrugore është që japë një kontribut të qëndrueshëm dhe afatgjatë, duke siguruar ecje të sigurt për të gjithë këmbësorët në botë.

Kjo mund të arrihet përmes një numri masash të cilat janë të njohura për të shpëtuar jetën e këmbësorëve. Disa nga këto masa përfshijnë:

- instalimin dhe/ose përmirësimin e kryqëzimeve, trotuareve, mbikalimeve, nënkalimeve, dhe sinjalistikës rrugore;
- uljen e shpejtësisë së automjeteve;
- hartimin dhe zbatimin e ligjeve të reja të trafikut mbi shpejtësinë, konsumin e alkoolit gjatë drejtimit të makinës, tërheqjen e vëmendjes gjatë drejtimit të makinës dhe ecjes;
- kufizimin ose largimin e automjeteve nga zonat e këmbësorëve;

- krijimin dhe sigurimin e standardeve të sigurisë të automjeteve të cilat mbrojnë këmbësorët.